



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE**



Nr. ____ Prot

Tiranë më ____ . ____ . 2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës -Sherbime

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Paketa software per mbrojtjen ndaj viruseve”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT

(CPV):48760000-3- Paketa software per mbrojtjen ndaj viruseve

VLERA E FONDIT LIMIT: 6,999,133 .33(Gjashte milion e nenteqind e nentehjete e nente mije e njeqind e tridhjte e tre pik tridhjte e tre) Leke pa TVSH.

Sigurimi i ofertës 2% e fondit limit sipas nenit 30, pika 3 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021, është **139983** (njetqind e tridhjte e nente mije nenteqind e tetedhjte e tre mije).

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **“Illyrian Guard SH.A.** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, **sipas shtojcës 10;**

b. Sigurimin e Ofertës, **sipas Shtojcës 3;**

Argumentimi: Kriteret e mesiperme jane vendosur ne perputhje me Nenin 82 “Formulari permbledhes i vetdeklarimit” dhe Neni 83 ”Sigurimi i ofertes”, te Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe ne mbështetje te nenit 26, nenit 30, pika 1, te VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik i ndryshuar: citojme Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashke me dorezimin e kerkesave per pjesemarrje ose te ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojne si prove paraprake ne vend te disa vertetimeve te leshuara nga autoritetet publike ose pale te treta, formularin permbledhes te vetdeklarimit, sipas parashikimeve te ketij ligji. Permbajtja e ketij formulari percaktohet ne rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës ose lotit që po prokurohet

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, **në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendorsja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, **ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.**

Argumentimi: Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe demonstron se Operatori Ekonomik ka aftësi financiare për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të kërkuar cilësie. Gjithashtu ky kriter është vendosur referuar Nenit 77 pika 3, e LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe nenit 43, pika 4 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në, si dhe Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

2.3. Kapaciteti teknik:

2.3.1.Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate/loti.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 40, pika 4 të VKM nr 285 dt 19.05.2021 për “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) duke qenë se vlera e fondit është brenda kufirit monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, si dhe aftësinë e tyre në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë:

- Çertifikate Sistem Menaxhim Cilësie ISO 9001:2015 ose ekuivalente
- Çertifikate Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit ISO IEC 27001:2018 ose ekuivalente
- Çertifikate Sistemit të Menaxhimit të Sherbimit IT ISO IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente
- Sistemin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit ISO 22301 : 2019 ose ekuivalente

Argumentimi: Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

1. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë - ISO 9001:2015 ose ekuivalente

Ky standard ndërkombëtar garanton që operatori ekonomik ka zbatuar një sistem menaxhimi cilësie që përmirëson vazhdimisht proceset. Kërkesa për këtë certifikatë siguron që shërbimet ose produktet e kontratës do të përmbushin standarde të larta cilësie dhe do të kryhen me efikasitet.

2. Certifikatë për Menaxhimin e Sigurisë së Informacionit - ISO/IEC 27001:2018 ose ekuivalente

Ky standard fokusohet në mbrojtjen e informacionit, duke identifikuar dhe menaxhuar rreziqet e sigurisë së të dhënave. Për operatorët ekonomikë që merren me të dhëna sensitive apo kritike, kjo certifikatë është thelbësore për të garantuar konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e informacionit, si dhe për të reduktuar rrezikun e shkeljeve kibernetike.

3. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shërbimit IT - ISO/IEC 20000-1:2011 ose ekuivalente

Ky standard siguron që operatori ekonomik menaxhon dhe ofron shërbime IT në përputhje me praktikatat më të mira ndërkombëtare. Ai ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve IT, duke siguruar mbështetje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme për klientët dhe përdoruesit përfundimtarë.

4. Certifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit - ISO 22301:2019 ose ekuivalente

Kjo certifikatë garanton që operatori ka hartuar dhe implementuar plane për të siguruar vazhdimësinë e operacioneve gjatë dhe pas incidenteve kritike (p.sh., fatkeqësi natyrore, sulme kibernetike). Kërkesa për këtë certifikatë garanton që shërbimet e ofruara nuk do të ndërpriten dhe se operatori është i përgatitur për çdo situatë emergjente.

2.3.3 .Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë

- a) 1 (një) punonjës të certifikuar si menaxher projekti.
- b) 1 (nje) punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalente)
- c) 1 (nje) punonjës të certifikuar ne nivel profesional per rrjetet kompjuterike(network)
- d) 1 (nje) punonjës të certifikuar per sigurine e rrjetit(network security)
- e) 1 (nje) punonjës të certifikuar per Cybersecurity
- f) 1 (nje) punonjës të certifikuar nga prodhuesi per zgjidhje te qenderzuar antiviruesi
- g) 1(nje) ing elektronik/informatic/teknologji informacioni,
(*shenim .nje punonjes mund te kete me shume se nje certifikim)

Për punonjësit e mësipërm Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Listë pagesat sipas formatit E-sig te pakten për 3 muajt e fundit.*
- *Diplomat e arsimit të lartë të kërkuara, origjinale ose të noterizuara.*
- *Kontratat e punës.*
- *Certifikatën e kërkuar, origjinale ose të noterizuar.*

a) 1 Menaxher projekti i certifikuar

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës . Certifikimi i menaxherit të projektit siguron zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në menaxhimin e projekteve. Ky kriter është i domosdoshëm për të garantuar që projekti të përfundojë sipas afateve dhe specifikimeve teknike të kërkuara. Menaxheri i projektit siguron koordinimin dhe drejtimin e saktë të burimeve dhe aktiviteteve gjatë gjithë ciklit të projektit, duke shmangur devijimet dhe duke mbajtur nivel të lartë performance.

b) 1 Punonjës për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL ose ekuivalent)

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Ky numer punonjesish kerkohet per te vertetuar se OE ofertues ka nje numer minimal punonjesish per te realizuar kontraten bazuar edhe ne mallin qe kerkohen te levrohen, afatit te levrimit dhe vleres se fondit limit te kontrates. Kërkesa për një punonjës të certifikuar për menaxhimin e shërbimeve IT (ITIL) bazohet në nevojën për të administruar në mënyrë të vazhdueshme dhe të efektshme shërbimet IT, duke siguruar një nivel të lartë të cilësisë dhe funksionimit. Certifikimi ITIL garanton që operatori ekonomik të ketë një qasje të strukturuar dhe të standardizuar në menaxhimin e proceseve të IT-së, gjë që redukton kohën e ndërprerjeve dhe përmirëson efikasitetin operacional. Ky rol është thelbësor për të siguruar që shërbimet IT të jenë të qëndrueshme dhe në përputhje me kërkesat teknike dhe operacionale të kontratës.

c) 1 Punonjës për sigurinë e rrjetit

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit siguria e rrjetit është një element kyç për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe të dhënave sensitive. Një punonjës i certifikuar garanton zbatimin e masave teknike për mbrojtjen

nga sulmet kibernetike dhe ndërhyrjet e paautorizuara. Ky kriter është i rëndësishëm për të parandaluar humbjet e të dhënave dhe për të siguruar vazhdimësinë e shërbimeve.

d) 1 Punonjës për Cybersecurity

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Pajisjet e kerkuara prodhojnë, transmetojnë dhe administrojnë informacione të rëndësishme dhe sensitive të cilat kërkojnë një sistem dhe administrim të sigurtë të të gjitha të dhënave. Me këtë kriter kërkohet të garantohet siguria e informacionit nga ndërhyrje kibernetike të qëllimshme apo aksidentale. Për këtë kërkohet që implementimi të garantohet nga a punonjës të kualifikuar.

e) 1 Punonjës i certifikuar nga prodhuesi për antivirus

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij të dëshmojnë aftësinë për të implementuar zgjidhje të sigurisë në nivel softuerik. Certifikimi nga prodhuesi i antivirusit siguron që zgjidhja e sigurisë është implementuar saktësisht dhe funksionon në nivelin maksimal të mbrojtjes. Ky punonjës është përgjegjës për konfigurimin dhe menaxhimin e antivirusit në të gjitha pajisjet e përfshira në projekt, duke minimizuar rrezikun e infektimit nga malware dhe duke mbrojtur të dhënat sensitive.

f) 1 Inxhinierë elektronik/informatik/IT

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/b/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Inxhinierët Elektronik /Kompjuterik/Informatik janë përgjegjës për zbatimin e saktë të objektit që prokurohet bazuar në njohuritë e përgjithshme që ofrojnë këto fusha

2.3.4 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori i autorizuar nga prodhuesi, i cili duhet të përfshijë mallrat objekt prokurimi.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur :

- për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues, për shkak të natyrës së veçantë të artikujve objekt prokurimi, si dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuara nga ofertuesit.

Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës. Me qellim moskufizimin e konkurrencës

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratë mbi origjinën e mallit (vendi i prodhimit të pajisjeve dhe kompania prodhuese) për të gjithë pajisjet objekt prokurimi perfshire dhe aksesoret. Kjo të vërtetohet me certifikatën e origjinës ditën e dorëzimit të dokumentacionit (DEKLARATE).

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 41 ,VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të garantuar përmbushjen e detyrimeve nga operatori ekonomik në përputhje me specifikimet dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor. Kjo deklaratë nevojitet për arsye se janë pajisje kundra sulmeve kibernetike ,origjina është një faktor i rëndësishëm për të siguruar që mallrat vijnë nga vende të besueshme dhe të certifikuara.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë (në mënyrë elektronike, në sistemin e APP-së) katalog për mallrat që oferton në mënyrë që të vërtetohet përputhja me specifikimet teknike të dokumentave të tenderit të autoritetit kontraktor. Në katalog duhet të markohet secili nga artikujt e ofertuar.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përket.

Nr.	Emërtimi i mallrave	Modeli i pajisjes	Emri i prodhuesit	Titujt e katalogeve, nr. faqes së katalogëve për çdo pajisje të ofruar, etj.	Faqja zyrtare e internetit të prodhuesit
-----	---------------------	-------------------	-------------------	--	--

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi.

2.3.7 Ofertuesi duhet të paraqesë deklaratë që merr persiper instalimin, konfigurimin dhe trajnimin e personelit për mallrat objekt prokurimi (DEKLARATE)

Argumentim: Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që OE ofertues do të paraqesë shërbimet objekt prokurimi në cilësinë e kërkuar nga AK, do t’i përgjigjet kërkesave të AK në rast instalimi dhe riparimi defektesh me qëllim realizimin me sukses të kontratës dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.8 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë deklaratë ku të përcaktojë se afatet e levrimin duhet të jene sipas afateteve të përcaktuara nga AK, brenda 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

Argumentim: Ky kriter është jo diskriminues është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.9 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër se koha e reagimit dhe riparimit të defekteve, do të jetë brenda 5 ditëve të javës, duke filluar nga marrja e kërkesës zyrtare (shkresore ose e-mail) të dërguar nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentim: Ky kriter është përcaktuar në mënyrë që AK të ketë garanci që operatori ekonomik ofertues do t’i përgjigjet kërkesave të AK në rast riparimi defektesh, me qëllim përmbushjen e misionit të Autoriteti Kontraktor të ofrimit të shërbimit .Dhe në mbështetje të nenit 77, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njesia e prokurimit: